

Mbi Auditimin e Ushtruar në Rezidencën Studentore Iniversitare Nr.1, SHA, Tiranë

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Rezidencën Studentore Universitare Nr.1, SHA, Tiranë, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën nga data 16/07/2014 deri më 12/10/2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 164 datë 15.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 688/14 datë 15.12.2014, dërguar Zj.Anila Shehu, Drejtor i Përgjithshëm Rezidencën Studentore Universitare Nr.1, SHA, Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve rezulton se është zbatuar një masë për propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, është realizuar, një masë administrative dhe 4 masa disiplinore rezulton se janë zbatuar. Nga 36 masa organizative të propozuara janë zbatuar 23 masa, janë në proces 8(tetë) masa dhe 5(pesë) masa nuk janë zbatuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet 24-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për të realizuar rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar apo janë në proces .

Menjëherë

2. Për vitin 2012, 2013 dhe 2014, nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk ka gjetur zbatim plotësisht Udhëzimi nr. 318, datë 08.09.2009 “Për emërimin, funksionimin e këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”; Nuk ka hartuar programet vjetore, nuk ka marrë në shqyrtim zbatimin e programit të auditimit, nuk kanë deklaruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës me shkrim pjesëmarrjen në këshillat e tjerë, nuk ka raportuar në METE/MZHETS për aktivitetin e kryer, nuk ka marrë në analizë asnjëherë gjendjen financiare të shoqërisë për vitin 2012, 2013. Nuk janë mbajtur procesverbale të rregullta për vitet 2012, 2013. Nuk është miratuar rregullorja e brendshme sipas ndryshimeve të strukturës në vitin 2014.

-Janë dhënë urdhra nga ish Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë për tarifat e akomodimit të studentëve pa marrë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës. Nga ish Administratori i përgjithshëm është dhënë urdhër për moslikuidimin e faturave për ujin, urdhër ky i jashtëligjshëm, pasi fatura tatimore është titull ekzekutimi. *Trajtuar më hollësisht në faqet 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për miratimin e rregullores së brendshme. Të lidhet kontrata ndërmjet Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm për administrimin e shoqërisë në zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 08.09.2009 “Për emërimin, funksionimin e këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”.

Menjëherë

3. U konstatua se për vitin 2012 e 2013, u konstatuan tejkalime të numrit të punonjësve, por brenda fondit të pagave, si dhe lëvizje të shumta të personelit të cilat kanë sjellë pagesa të pagave të punonjësve të larguar me urdhër nga ish Administratori i Përgjithshëm me vlerë prej **2,726,030 lekë**. Aktualisht janë ngritur 38 padi gjyqësore nga ish punonjësit, të cilët janë larguar nga puna në vitin 2012, 2013 dhe 2014. Sipas vendimeve të gjykatës vlera e kërkuar prej tyre paraqitet në total në shumën 29,306,979 lekë, vlerë e cila do të rëndojë gjendjen financiare të shoqërisë. *Trajtuar më hollësisht në faqet 83-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të zbatuar procedurat e largimit nga puna të punonjësve në zbatim të Kodit të Punës, duke ndjekur me përgjegjësi afatet të përcaktuara sipas shkallëve të gjyqësorit, për paditë gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë.

Menjëherë

4. Procedurat e ndjekura për përgatitjen, dhe miratimin e projektbuxhetit për treguesit ekonomik e financiar të shoqërisë për vitet 2012, 2013 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2014, janë në shkelje të Udhëzimit nr. 315, datë 8.04.2009, për arsye se janë paraqitur me vonesë në Këshillin Mbikëqyrës dhe janë dërguar jashtë afateve ligjore në MAS dhe në MZHETS. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Departamenti ekonomik i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për të përgatitur dhe paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, projektbuxhetin ekonomik të shoqërisë dhe të dërgojë për miratimin në MZHETS dhe në MAS, brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 315, datë 8.04.2009.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Konstatohet se shoqëria nuk disponon një inventar mbi kapacitetet maksimale të dhomave për strehimin e studentëve, të përgatitura për çdo vit akademik nga administratorët e Bujtinave, të miratuara nga Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, me qëllim shmangien e përdorimit abuziv të dhënies me qira të dhomave për studentët nga administratorët e bujtinave. *Trajtuar më hollësisht në faqet 75-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Departamenti i Bujtinave në bashkëpunim me departamentin ekonomike, të marrin masa për të përgatitur një databazë mbi inventarin e kapacitetin maksimal të dhomave që janë të disponueshme për çdo vit akademik, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, me qëllim administrimin e drejtë të tyre, dhe mënjanimin e përdorimit abuziv të dhomave nga administratorët e godinave.

Menjëherë

6. Për vitin 2012, konstatohet se, janë zbatuar tarifat për qiratë për hotelin që i përkasin godinës 13, bazuar vetëm në urdhrin nr. 160, datë 21.09.2012, [REDAKTUAR] ish-administrator i përgjithshëm, pa marrë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, veprim që bie ndesh me statutin e shoqërisë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 75-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për të aplikuar tarifën për qiratë e hotelit në mesin 13, të cilat të jenë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjatë vitit 2012, shoqëria ka bërë ndryshime në programin ekonomik respektivisht:-ka mbyllur aktivitete të parashikuara në programin ekonomik, pa marrë më parë miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë;- nga 18 kontrata të parashikuara në programin ekonomik për objekte me qera, janë lidhur 26 kontrata, dhe për këtë ndryshim në programin ekonomik, nuk ka miratim nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, veprim ky në kundërshtim me nenin 13, pikë 6/a, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës ka kompetencë që të përcaktojë ndryshimet në programet e veprimtarisë afatshkurtër, afatgjatë dhe afatmesëm të shoqërisë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtoria e shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për çdo ndryshim në programet ekonomike, qoftë për hapjen apo mbylljen e aktiviteteve të shoqërisë dhe për lidhjen e kontratave për qiratë e objekteve gjatë vitit, me miratim paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, nga MZHETS dhe nga MAS.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Këshilli Mbikëqyrës, nuk ka bërë analiza të hollësishme në lidhje me vlerën reale të subvencionit që nevojitet për të përballuar shpenzimet e shoqërisë, dhe organet drejtuese të shoqërisë, nuk kanë bërë kërkesa pranë MAS, për të rritur masën e subvencionit për shkak të ndikimit të çmimit të energjisë elektrike dhe të ujit, me qëllim mbulimin e shpenzimeve dhe uljen e humbjeve nga faktorë që nuk lidhen drejtpërdrejtë me aktivitetin e shoqërisë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Mbikëqyrës dhe organet drejtuese të shoqërisë të marrin masa për të analizuar realizimin e shpenzimeve të shoqërisë, për gjetjen e rrugëve për uljen e zërave të shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, me qëllim uljen e humbjes nga aktiviteti i shoqërisë. Për këtë organet drejtuese të shoqërisë duhet të paraqesin kërkesa të argumentuara në MZHET dhe MAS, për rritjen e subvencionit, për të përballuar ndikimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe ujit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Shoqëria ka ndryshuar numrin mesatar të punonjësve dhe pagën mesatare, respektivisht, në vitin 2012, numri mesatar i punonjësve nga 445 të parashikuar, në fakt është 468 punonjës, me një tejkalim me 23 persona, dhe paga mesatare është ulur në masën 8% nga ajo e programuar; nga janari deri në tetor në vitin 2013, numrin mesatar i punonjësve, nga 445 persona të parashikuar, ka shkuar në 470 persona, me një shtesë prej 25 persona, dhe paga mesatare është 6% më e ulët se ajo e miratuar.

Ndryshimet në strukturë, janë bërë vetëm me urdhër të [REDAKTUAR] ish- administrator i përgjithshëm i shoqërisë, pa marrë më parë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës, në MAS dhe në MEZHTS, si pronar i vetëm i shoqërisë, veprime këto që bien ndesh me neni 16, pika 6, të statuti i shoqërisë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtoria të marrë masa në të ardhmen për çdo ndryshim në numrin mesatar të punonjësve dhe në rritjen ose uljen e pagës mesatare, të bëhen vetëm me miratim të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, MZHETS dhe MAS, në përputhje me përcaktimet e bëra në statutin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Procesi për ndjekjen e procedurave ligjore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë pranë Zyrate Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë, ka nisur që nga vitit 2012 dhe vazhdon akoma, megjithëse janë planifikuar fonde në programin ekonomik për pagesat e tarifave përkatëse, të cilat rezultojnë se nuk janë përdorur. Gjithashtu nuk janë bërë pagesat e taksave vendore që priten të bëhen nga rivlerësimi i tyre për regjistrimin e pasurisë nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, Bashkia, Tiranë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrin masa për të bashkëpunuar me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme në Tiranë, për të ndjekur dhe përfunduar procesin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të shoqërisë, dhe rivlerësimin e tyre në Bashkinë e Tiranës.

Menjëherë

11. Shoqëria ka përfshirë në zërin "shpenzime të tjera", shpenzimet për aktivitete kulturore dhe shpenzimet për akomodimin e studentëve, të cilat duhet të ishin parashikuar si aktivitete që në fillim të vitit nga departamenti ekonomik dhe departamentet e tjera, dhe të programoheshin në zërat përkatës të shpenzimeve. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, të marrin masa për të bërë një planifikim sa më të studiuar të aktiviteteve që do të kryhen gjatë vitit, me qëllim që të parashikohen dhe të miratohen zërat e shpenzimeve sipas aktiviteteve në programin ekonomik në fillim të çdo viti akademik.

Menjëherë

12. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, nuk ka marrë masa për të ushtruar kompetencat statutore, për të kërkuar në MAS dhe MZHETS, si pronar i vetëm i shoqërisë, gjetjen e zgjidhjeve të mundshme ligjore për detyrimin e lindur që nga data 13.06.2006, [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtor, i cili ka fituar gjyqin me vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 193, datë 02.03.2006, dhe pagesat vazhdojnë të kryhen rregullisht, deri në kohën e sistemit në vendin e mëparshëm të punës. Kjo gjë i ka kushtuar shoqërisë pagesa të tepërta të barabarta me pagën mujore në shumën 1.5 milion

lekë të Drejtorit që nga data 13.06.2006 e në vazhdim. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë dhe drejtoria, të kërkojnë zgjidhjen e menjëhershme ligjore në MZHETS dhe të vazhdojnë të insistojnë në MAS, për të parashikuar fonde nga buxheti i shtetit për të përballuar detyrimin e trashëguar ndër vite për [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtor, i cili i ka kushtuar shoqërisë me pagesa të barabarta me pagën mujore sa për dy drejtorë të përgjithshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Aktiviteti i shoqërisë ka rezultuar me humbje në vitin 2012, në vlerën 75.3 milion lekë, dhe në vitin 2013, në vlerën 55.4 milion lekë. Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, kanë munguar analizat mbi shkaqet që kanë çuar në thellimin e humbjes, dhe nuk është analizuar puna e bërë nga ana e departamenteve të shoqërisë, për pasojë nuk janë marrë masa për të përmirësuar situatën financiare për të ardhmen, për gjetjen e burime të reja për rritjen e të ardhurave dhe uljen e shpenzimeve. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Mbikëqyrës të ushtrojë kompetencat e tij, të përcaktuara në Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 të METE/MZHETS “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, dhe të marrë menjëherë në analizë gjendjen financiare të shoqërisë, duke dalë me propozime konkrete për përmirësimin e gjendjes, me qëllim që aktiviteti i shoqërisë të jetë më rentabël, për gjetjen e burimeve të reja për rritjen e të ardhurave dhe uljen e humbjeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14. Për vitet 2012 dhe 2013, mbledhja e të ardhurave nga familjarët për objektet me qira ka qenë me problematika, pasi nuk është arritur të arkëtohen detyrimet nga familjarët të cilët ndër vite dhe në mënyrë sistematike nuk kanë paguar qiratë mujore. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtoria e shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin në analizë punën që kryhet nga departamenti i bujtinave, mbi administrimin e objekteve me qira nga familjarët, me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe marrjen e masave organizative për të detyruar debitorët të arkëtojnë qiratë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Për të ardhurat që realizohen nga dhënia me qira e ambienteve nga akomodimi i studentëve, “Trajtimi i studentëve nr. 1” SHA, megjithëse është një shoqëri aksionare, nuk aplikon fatura tatimore për shërbimet që kryen, detyrë kjo e lënë dhe grupi i auditimit të mëparshëm të KLSH-së. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, Tiranë, të marrë masat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me miratim të MZHETS dhe MAS, për të aplikuar fatura tatimore me TVSH, për arkëtimin e qirave për akomodimin e studentëve në godinat nën administrim të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Konstatohet se, bilanci kontabël për periudhat ushtrimore 2012 dhe 2013, janë audituar nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga ish-administratori i përgjithshëm, dhe në përfundim kanë dhënë opinion pozitiv për pasqyrat financiare; por nga auditimi i bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2012, u konstatuan pasaktësi në kontabilizimin dhe në llogaritjen e detyrimit ndaj buxhetit të shtetit, për të ardhurat nga kontratat për objektet me qira. Nga financa e shoqërisë nuk është kryer ende pagesa për tre ekspertët kontabël, të cilët kanë certifikuar bilancin dhe pasqyrat financiare për vitin 2013. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtori i përgjithshëm i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për kontratat që do lidh me ekspertët kontabël që do të auditojnë llogaritë kontabël, të përcaktojnë modalitete në lidhje me përgjegjësitë e ekspertëve nëse konstatohen mangësi pas certifikimit të bilancit nga ana e tyre, dhe në përfundim të punës të dorëzojnë një raport të gjatë financiar mbi gjendjet e llogarive kontabël dhe pasqyrat financiare. Pagesa e tyre të bëhet pasi të jetë dokumentuar produkti i punës për të cilën janë kontraktuar.

-Për sa i takon pagesave të ekspertëve për vitin 2013, nga ana e shoqërisë të merren masa që të kryhen veprimet e pagesave pasi ekspertët të dorëzojnë një raport të gjatë financiar për certifikimin e llogarive kontabël për vitin ushtrimor 2013.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17. Këshilli Mbikëqyrës dhe drejtoria e shoqërisë, nuk kanë marrë masa për të shqyrtuar dhe analizuar gjendjen e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe nuk kanë marrë vendim për të provizionuar këto detyrime në shumën 3,343,014 lekë; Për këtë jo vetëm që nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të trashëguara në vite, por mungon dokumentacioni për të vërtetuar se shoqëria ka bërë të gjitha përpjekjet për mbledhjen e borxheve të pa arkëtuara, duke rënë ndesh nenin 12, pika 3. g dhe 3. gj, të ligjit nr. 10296, date 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të llogarisë provizione për llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra, “Klient për mallra, produkte e shërbime”, në shumën 3,343,014 lekë, për të cilët është i pamundur arkëtimi i tyre për arsye se me urdhër të MZHETS, janë ndërprerë kontratat me familjarët për objektet me qira.

Menjëherë

18. Në bilancin e vitit 2013, janë paraqitur në llogaritë aktive afatgjata jo materiale me vlerën e mbetur në shumën 467,711 lekë, që përfaqëson investimin e një projekti të kryer në vitet 2005 dhe 2006, duke i klasifikuar si aktive afatgjata jo materiale (klasa 2). Ky investim dhe projekti i tij ende nuk ka filluar, por nga financa e shoqërisë është aplikuar amortizimi në masën 15%, mbi vlerën fillestare të projektit në shumën 1.6 milion lekë. Kjo do bëjë që me kalimin e viteve vlera fillestare e projektit, si rezultat e kontabilizimit të gabuar të mos figurojë më me gjendje në llogaritë kontabël të shoqërisë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Departamenti ekonomik i shoqërisë, të bëjë regjistrimin në llogaritë kontabël me veprime sistemimi për vlerën e projektit dhe pasqyrimin e vlerës fillestare në shumën 1,616,610 lekë si llogari jashtë bilancit, në mënyrë që të mos aplikohet norma e amortizimit, për periudhën derisa të fillojë zbatimi i investimit të parashikuar sipas këtij projekti.

Menjëherë

19. Megjithëse në fund të vitit 2013, shoqëria është me gjendje të madhe mjeteve monetare në bankë, nga organet drejtuese të shoqërisë nuk janë marrë masat për ti dhënë prioritet likuidimit të detyrimeve ndaj furnitorëve në shumën 221,091,752 lekë, të trashëguara në vite dhe të krijuara nga vitet ushtrimor, përkatësisht:-në shumën 138,148,679 lekë, detyrime për energji elektrike ndaj CEZ bazuar në aktrakordimet; -në shumën 51,565,170 lekë, janë detyrime për ujin ndaj UKT-së; -në shumën 7,750,247 lekë, detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për investime; -në shumën 15,690,499 lekë, detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për furnizime materiale të ndryshme; -në shumën 7,937,164 lekë, detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për shërbime të ndryshme. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për të analizuar në Këshillin Mbikëqyrës, menaxhimin e mjeteve monetare të shoqërisë, me qëllim që të mos mbahen gjendje mjetet monetare të lira në llogaritë bankare, por ti jepet prioritet likuidimit të detyrimeve të shoqërisë ndaj furnitorëve për shërbimet ose mallrat e blera.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

20. Nga auditimi i bilancit kontabël i vitit ushtrimor 2013, paraqitet me gjendje në llogarinë aktive “Të pagueshme ndaj punonjësve”, në shumën 192,222 lekë, që përfaqësojnë detyrimet për paga e shpërblime për leje të zakonshme ndaj punonjëse që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës para vitit 2012 dhe nuk u dihet adresa. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të llogarisë provizione për llogaritë aktive “Të pagueshme ndaj punonjësve”, në shumën 192,222 lekë, për të cilat nuk ka mundësi likuidimi nga shoqëria, për arsye se punonjësit kanë shkëputur marrëdhëniet e punës nga kjo shoqëri.

Menjëherë

21. Në bilancin e vitit 2013, konstatohet se paraqitet me gjendje në llogaritë detyrime afatshkurtëra në shumën 2,362,579 lekë, respektivisht:

- "Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore", që përfaqësojnë detyrimet e shoqërisë ndaj ISK SH-së, të trashëguara nga viti 2004, në shumën 985,762 lekë;

- Gjendja e llogarisë "Detyrime tatimore për TAP-in", që përfaqësojnë detyrime të papaguara ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore që nga vitit 2004, në shumën 1,100,403 lekë;

- Gjendja në llogarinë "Te drejta dhe detyrime te tjera, (467,424)", janë në shumën 24,000 lekë, që përfaqësojnë detyrimet përmbarimore të trashëguara nga vitet të mëparshme ndaj një punonjëse të larguar nga puna.

- Gjendja në llogarinë "Detyrime tatimore për tatimin në burim", janë në shumën 252,414 lekë, përfaqësojnë pagesat e lejeve të zakonshme për punonjësit që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës dhe pagesa është bërë për sasinë e ditëve për lejen e zakonshme, pas datës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për të provizionuar detyrimet në shumën 2,362,579 lekë, përkatësisht: për detyrime të trashëguara nga vitit 2004, ndaj ISKSH në shumën 985,762 lekë; detyrime të trashëguara nga vitit 2004 në shumën 1,100,403 lekë, të papaguara ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore që nga vitit 2004; detyrimet në shumën 24,000 lekë, që përfaqëson detyrimet përmbarimore të trashëguara nga vitet të mëparshme ndaj një punonjëse; detyrimet në shumën 252,414 lekë që përfaqëson pagesat e lejeve të zakonshme për punonjësit që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës për sasinë e ditëve për lejen e zakonshme, pas datës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Menjëherë

22. Në bilancin e vitit 2013, paraqitet me gjendje në llogaritë "Kreditorë të tjerë", që përfaqëson detyrimin e shoqërisë për objektet me qira ndaj shtetit, në fund të vitit 2013, në shumën 4,130,380 lekë, që përfshin; në shumën 306,118 lekë, përfaqëson detyrimet të pa derdhur për tatimin mbi pasuritë të trashëguara që para vitit 2004;- në shumën 3,824,262 lekë, përfaqëson detyrimin ndaj buxhetit të shtetit për të ardhurat e realizuara nga kontrata shumëvjeçare të lidhura nga METE, nga kjo: në shumën 1,738,475 lekë, janë detyrime të pa derdhura nga viti 2012; në shumën 2,085,787 lekë, detyrimi i llogaritur në masën 30%, për vitin 2013. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marri masa për të derdhur detyrimet ndaj shtetit në shumën 3,824,262 lekë, për kontratat shumëvjeçare të lidhura nga MZHETS për vitin 2012 dhe 2013, si dhe të llogarisë si provizione shumën 306,118 lekë, për një detyrim të shoqërisë të pa derdhur për tatimin e fitimit të pasurisë të trashëguar që para vitit 2004.

Menjëherë

23. Shoqëria nuk ka zbatuar VKM nr. 529, datë 8.06.2011, për detyrimet ndaj buxhetit të shtetit për kontratat e lidhura për objektet me qira, respektivisht:

- në vitin 2012, për kontratat e lidhura nga shoqëria, llogaritet një detyrim ndaj shtetit në shumën 3,730,470 lekë. Në fakt është llogaritur dhe kontabilizuar si detyrim për vitin 2012, në shumën 1,738,475 lekë, me një diferencë më pak në shumën 1,991,995 lekë.

-për kontratat e lidhura për objektet me qira në vitin 2013, llogaritet një detyrim ndaj shtetit në shumën 3,825,316 lekë, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.06.2011. Në fakt është llogaritur dhe kontabilizuar si detyrim për vitin 2013, është në shumën 2,085,787 lekë, me një diferencë më pak në shumën 1,739,529 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar detyrimin në shumën 1,991,995 lekë, diferencën nga detyrimi i pa llogaritur për kontratat që ka lidhur shoqëria për vitin 2012, dhe në shumën 1,739,529 lekë , diferencën nga detyrimi i pa llogaritur për kontratat që ka lidhur në vitin 2013, për objektet me qira, dhe të derdhë në buxhetin e shtetit, detyrimin në shumën 3,731,524 lekë, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.06.2011.

Menjëherë

24. Konstatohet se për vitin 2012, nuk u janë kthyer studentëve detyrimet për garancitë të arkëtuara, në shumën 8,823,800 lekë. Nga dega teknike ka rezultuar se ka pasur dëmtime në dhoma nga studentët. Ndalesat për zhdëmtimin e vlerës së dëmit, janë bërë nga financa, duke u bazuar vetëm në kartelat e studentëve, dhe nga ish-Administratori i Përgjithshëm nuk ka dalë urdhër zhdëmtimi për personat përgjegjës për vlerat që duhet të zhdëmtojnë, veprime këto që bien ndesh me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të përlllogaritur vlerën e dëmit të shkaktuar nga studentët duke zbatuar procedurat ligjore për ndalesat e siguracioneve të studentëve dhe ndalesat nga financa e shoqërisë të bëhen me urdhër zhdëmtimet në përputhje me vlerën e dëmit të shkaktuar nga personat përgjegjës.

Menjëherë

25. Janë konstatuar parregullsi në procedurat e ndjekura për inventarin e kryer gjatë vitit 2012, pasi nuk janë përgatitur dhe plotësuar procesverbalet e komisioneve të inventarizimit dhe nuk janë kryer brenda afateve të përcaktuara në urdhrat e inventarëve, duke rënë ndesh me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *Trajtuar më hollësisht në faqen 57-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për të zbatuar me përpikmëri procedurat e inventarizimit të aseteve të shoqërisë dhe të bëjë pasqyrimin e plotë të rezultateve të inventarit në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

26. Në vitin akademik 2012-2013, nga 2006 dhoma për strehim janë përdorur për studentët 1967 dhoma, ose 39 dhoma më pak, ndërsa në vitin akademik 2012-2013, nga 2006 dhoma për strehim u përdorën për studentët 1842 dhoma, ose 164 dhoma më pak, duke shkaktuar të ardhura të munguara për shoqërinë në vlerën 44,775,000 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 75-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të shfrytëzuar gjithë kapacitetet e dhomave që disponojnë për strehimin e studentëve, me qëllim realizimin e të ardhurave nga aktiviteti kryesor i shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

27. Nga auditimi i kryer rezulton se, në vitin 2012 me urdhër të [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm, është bërë ndryshimi i tarifës nga 45,000 lekë në 40,000 lekë, pra 5,000 lekë për më pak për çdo student të regjistruar, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për aktivitetin e shoqërisë nga qiratë e studentëve në vlerën 28,240,000 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 75-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të zbatuar tarifat për strehimin e studentëve me miratim të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë me qëllim realizimin e të ardhurave të programuara nga qiratë e studentëve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

28. Janë evidentuar disa mangësi në plotësimin e dokumentacionit në dosjet e kontratave të nënshkruara me subjektet të cilat kanë marrë me qira ambientet e “Trajtimit të studentëve Nr. 1”, SHA, Tiranë për periudhën 2012-2014, veprime në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 529, datë 08.06.2011. *Trajtuar më hollësisht në faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për plotësimin e dosjeve të kontratave me dokumentacionin përkatës ligjor, para nënshkrimit të kontratës me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

29. U konstatua se, në disa kontrata të lidhura midis Trajtimit të Studentëve Nr. 1, SHA, Tiranë dhe subjekteve, mungon përcaktimi i detyrimit që subjektet që ushtrojnë aktivitet në hapësirat nën administrimin e shoqërisë, të dorëzojnë paraprakisht kontratat e lidhura me Ujësjiellës Kanalizime SHA dhe me CEZ Shpërndarje, për të mos krijuar hapësira për favorizime. *Trajtuar më hollësisht në faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për unifikimin e kontratave me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim të shoqërisë në lidhje me detyrimet kontraktuale të Ujësjellës Kanalizime SHA dhe me OSHEE.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

30. Për periudhën 2012-2013 nga Trajtimi i Studentëve Nr1 sot RSU nr. 1, SHA, nuk është kryer monitorimi i kontratave të qirasë ose enfiteozë, në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë mbajtur as procesverbalet e dhënies dhe marrjes në dorëzim të objektit të dhënë me qira, gjithashtu nuk është ndjekur në vijimësi respektimi i kushteve të këtyre kontratave në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, paragrafi VI, pikat 1 dhe 2. *Trajtuar më hollësisht në faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa në të ardhmen të monitorojë kontratat e qirasë ose enfiteozë, si dhe të mbajë dokumentacionin përkatës të dhënies dhe marrjes në dorëzim, duke ndjekur në vijimësi respektimin e kushteve të kontratës me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

31. Në të gjitha procedurat e prokurimeve në Trajtimin e Studenteve Nr. 1 SHA, për vitin 2012, 2013, procedurat e prokurimit “Negocim pa botim paraprak”(20%), Shtesë Kontrate për rikonstrukcione të objekteve të përfshira në zërin investime (231) të audituara rezultojnë se:

-Procedura e prokurimit shtesë kontrate për “Rikonstrukcion i Godinës nr. 1 të godinës së Qytetit Studenti” nëntor 2012, është bërë në kushtet kur nuk kemi situata të paparashikuara për punimet shtesë në preventiv për punime elektrike e sidomos ato të gjelbërimit. Shtesa e sipërfaqes së gjelbëruar prej 500 m² nuk është pjesë e godinës Nr. 1, por sipërfaqe e ambiente të përgjithshme të Qytetit Studenti dhe për këtë zë punimesh nuk kemi një projekt zbatimi të miratuar nga AK sipas kontratës bazë. Gjithashtu dhe sipërfaqja prej 35 m² nuk është e përfshirë në projekt zbatim të miratuar nga titullari i AK, por vetëm në preventiv, aq më tepër shtesa në 450.55 m².

-Procedura e prokurimit shtesë kontrate për “Hidroizolim i godinave 4, 12, 13 dhe Bibliotekës së Qytetit Studenti”, dhjetor 2012, u konstatua se nuk ishin të nevojshme punimet shtesë të shkaktuar nga rrethana të paparashikuara nga Autoriteti Kontraktor. Për këto punime shtesë duhet të kryhej një procedurë tjetër prokurimi pikërisht mbi sipërfaqen e hollit të godinave 7, 8, 11, dhe 12, për hidroizolim, i pa parashikuar në preventivin e kontratës fillestare, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 33, pika 5/a, dhe VKM-në Nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, kreu IV pika 5.

- Procedura e prokurimit shtesë kontrate për “Lyerje me gëlqere të godinave Nr nga 1-12;14-17;dhe 20-29” të Qytetit të Studentit, nëntor 2012”, nuk ishte e nevojshme për punime shtesë të shkaktuar nga rrethana të paparashikuara nga Autoriteti Kontraktor. Për këto punime shtesë duhet të kryhej një procedurë tjetër prokurimi. Shtesa e kontratës është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 33, pika 5/a, dhe VKM-në Nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, kreu IV pika 5. Mungojnë proces-verbalet për punime të paparashikuara dhe të pa përfshira në kontratën fillestare, pasi godinat nr, 16, 17, 22, 23; Nga ana e Autoritetit Kontraktor i Trajtimi i Studentëve Nr. 1 SHA, në lidhje me procedurat e mësipërme nuk është

ngritur Komisioni për negocimin e ofertës, në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 33, pika 5/a dhe VKM-në Nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar, kreu IV pika 5. *Trajtuar më hollësisht në faqen 122-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për procedurat e prokurimit “Negocim pa botim paraprak”(20%), Shtesë Kontrate, që të realizohen në mbështetje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 33, Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, pika 5/a dhe VKM-në Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, kreu IV pika 5, duke realizuar më parë argumentimet në përputhje të dokumentacioneve ligjore, administrative dhe teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Në procedurën e audituar mbi realizimin e investimit të kryer për objektin “Rikonstruksion i Godinës nr.1, të godinës së Qytet Studenti” Nëntor 2012, konstatohet se, janë nisur dhe përfunduar investimet pa marrë më parë lejen e ndërtimit nga Bashkia Tiranë, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për Urbanistikën”, me ndryshimet e mëvonshme neni 45 dhe nenin 48, të Ligjit Nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, pasi ka hyrë në fuqi më datë 01.10.2011. *Trajtuar më hollësisht në faqen 122-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejeve zhvillimore e ligjshmërisë për të gjitha investimet që do të realizohen, qofshin ndërtime të reja apo rikonstruksiione të ndërtimeve ekzistuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Në të gjitha procedurat e prokurimeve publike të kryera nga shoqëria për vitet 2012, 2013, procedurat e prokurimi “Negocim pa botim paraprak”(20%), Shtesë Kontrate për rikonstruksiione të objekteve, ka rezultuar se:

KVO nuk ka pasur në përbërje të saj specialist të fushës në rastin konkret Ing. Ndërtimi, me qëllim vlerësimin e shqyrtimin e ofertave të objektit të prokurimit në mënyre profesionale, kryesisht të kërkesave të veçanta për kualifikim dhe të specifikimeve teknike. Pra përbërja e anëtarëve të KVO-së është në kundërshtim me kërkesat e pikës 2/ç “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për pasojë në disa objekte tenderimi janë s’kualifikuar pa të drejtë operatorët ekonomikë, duke vënë në dyshim procedurën e tenderimit. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për përcaktimin e anëtarëve të KVO-së, në plotësim të pikës 2/ç “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Në procedurat tenderuese për objektin “Ndërtim i Sistemit Hidrosanitar dhe ngrohje në godinën nr. 1, të Qytetit Studenti”, për vitin 2012, ka rezultuar se KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në këtë procedure; Janë s’kualifikuar për mangësi të rezultuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta 9 operatorë. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues subjektin OE “██████”, i cili ka paraqitur dokumente jo të rregullta për kapacitetin ligjor të tij, në kundërshtim me nenin 44 pika 2, dhe nenin 46, germën ç, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe me pikën 2, të Kreut VII, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”. Për pasojë nuk është përmbushur qëllimi kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 1, duke i bërë që **shuma 2,228,950 lekë**, të mos përdoret me efektivitet në favor të Trajtimit të Studenteve Nr. 1 SHA Tiranë.

- Në procedurat tenderuese për objektin “Lyerje me gëlqere të godinave Nr. 1-12; 14-17; dhe 20-29” të Qytetit të Studentit, për vitin 2012, u konstatua se, KVO ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në këtë procedure; Ka s’kualifikuar për mangësi të rezultuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta 5 operatorë, dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE ██████ me dokumentacion jo të rregullt për kapacitetin ligjor të tij, në kundërshtim me pikën 2/ç, të nenit 44, dhe neni 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe pikën 2, të Kreut VII, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007. Për pasojë nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1, duke bërë që **shuma 370,911 lekë**, të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të Trajtimit të Studenteve Nr. 1 SHA, Tiranë. *Trajtuar më hollësisht në faqen, 105-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa që nga ana e KVO-ve të vlerësohen kriteret e kualifikimit të pranimit të operatorëve ekonomikë në bazë të pikës 2/ç, të nenin 44, dhe nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe me pikën 2, të Kreut VII, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Në procedurat tenderuese për objektin “Hidroizolim tarrace të godinave nr. 4, 12, 13 dhe të Bibliotekës së Qytetit Studenti”, përlllogaritja e vlerës së kontratës (fondi limit), është llogaritur nga anëtarët e njësisë së prokurimit, sipas proces-verbalit nr.1 datë 13.04.2012, nuk është në mbështetje të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM-në Nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu II, pika 2,ç. Përlllogaritja e fondit limit u konstatua se nuk ishte argumentuar mbi nevojën e këtij shërbimi dhe identifikimin e shkaqeve që çojnë për shërbimin e kërkuar. AK përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, nuk ka miratuar Urdhrin “Për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt “Hidroizolim tarrace të godinave nr. 4, 12, 13 dhe të Bibliotekës së Qytetit Studenti”.

-Në procedurat tenderuese për objektin “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike të Qytetit Studenti” të Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA, Tiranë, prill 2013, përlogaritja e fondit limit është thjesht një proces-verbal testim tregu të datës 13.05.2013, ku shprehet se komisioni është bazuar në testimin e tregut për hartimin e preventivit për objektin e prokurimit, sipas tre ofertave nga tre kompani të ndryshme duke marrë parasysh çmimet më të ulëta dhe duke bërë krahasimin me çmimet e kontratës së vitit 2012. Proces verbali mban datën 13.05.2013, pra 39 ditë mbas daljes së Urdhër Prokurimit nr. 1, të datës 04.04.2013, gjë e cila fakton se procedura për testimin e tregut është formale dhe jo sipas kërkesave të Ligjit të Prokurimit Publik, pasi nuk i përkon periudhës para daljes së urdhër prokurimit. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoritetit Kontraktor të marrë masa, që të bëjë përlogaritjen e argumentuar të fondit limit nga një grup pune i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me Njësinë e Hartimit të Dokumenteve, në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM-në Nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II, pika 2,ç.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Për procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2012, u konstatua se drejtuesit teknik për ndjekjen e punimeve të tenderave, në të gjitha rastet janë caktuar sipas Urdhrave të dala nga titullari Autoritet Kontraktor [REDAKTUAR] duke anashkaluar dhe mos zbatuar rregullat e Prokurimit Publik. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoritetit Kontraktor të marrë masa për çdo rast që përcaktimi i drejtuesve teknik në ndjekjen e punimeve të mos bëhen me Urdhra nga Titullari i institucionit, por në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Konstatohet se në kontratën e lidhur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me subjektin kontraktues [REDAKTUAR] shpk, me objekt “Blerje material ndërtimi për Qytetin Studenti” të Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA, nuk është autorizuar personi apo grup personash lidhur me monitorimin dhe zbatimin e kontratës të lidhur me këtë subjekt kontraktues, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2/b “Mbikëqyrja e kontratës”, Kreu VIII “Ekzekutimi i kontratës” të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të caktohen persona apo grup personash për ndjekjen e realizimit të kontratave të lidhura, për të bërë të mundur realizimin e tyre dhe garantimin e cilësisë së punimeve, si dhe për çdo rast të hartohen raporte përmbledhës ku të shprehen mbi ecurinë e monitorimit dhe zbatimit të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

38. Në të gjitha rastet e ri shpalljes së procedurave të anuluarra për prokurimet e kryera për vitet 2012-2013, u konstatua se nga ana e Titullarit të AK nuk është nxjerrë Urdhër Prokurimi për rinisjen e procedurës, veprim ky në kundërshtim me VKM-në Nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 1/a, por është realizuar vetëm me dërgimin e formularit të njoftimit të kontratës në APP. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Në çdo rast nga Autoriteti Kontraktor, në kushtet e rinisjes së një procedure të anuluar prokurimi, të nxirret Urdhër Prokurimi sipas dhe në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Nga Njësia e Hartimit të Dokumentave janë vendosur kriteret për kualifikim për çdo procedurë prokurimi të njëjta, duke bërë që për procedurat e prokurimeve, të ketë ankesa nga Oferuesit Ekonomik dhe tenderat të jenë të destinuar për anullim. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Njësia e Hartimit të Dokumentave të vendosen kriteret e veçanta për kualifikim të operatorëve ekonomik, duke pasur parasysh natyrën e tenderit që do të zhvillohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

40. Për asnjë rast nga Autoriteti Kontraktor nuk është përpiluar relacion ose proces verbal ku të analizoheshin shkaqet, që kanë sjellë për pasojë dështimin e procedurës dhe ti korrigjonte ato në mënyrë, që të mundësonte rritjen e konkurrencës, veprim ky në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, kreu VII, pika 1/b. *Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoriteti Kontraktor për të gjitha rastet e anulimit të procedurave të prokurimit, duhet të analizojë arsyet dhe shkaqet që kanë çuar në anulim, sipas VKM nr.1, datë 10.01.2007, kreu VII, pika 1/b.

Menjëherë dhe në vijimësi

41. Lidhur me vlerësimin e gjendjes ekonomike financiare të operatorit ekonomik fitues [REDAKTUAR] në tenderin “Ndërtim i Sistemit Hidrosanitar dhe ngrohje në godinën nr 1 të Qytetit Studenti”, për vitet 2010 dhe 2011, kopjet e certifikuar të bilanceve të shoqëruara me raportet e ekspertit kontabël të paraqitura nga operatori fitues [REDAKTUAR], për vitet 2010 dhe 2011, u konstatua se, mungonte vula e Drejtorisë së Tatimeve dhe raportet e ekspertit kontabël. Raporti i ekspertit kontabël i paraqitur për bilancin i vitit 2010, rezultoi se relacioni mbante datën 14 Mars 2010, që

do të thotë se relacioni i paraqitur i përket vitit ushtrimor 2009 dhe jo vitit ushtrimor 2010. Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Komisioni i Hartimit të Dokumenteve të marrin masa në të ardhmen për të verifikuar saktësinë e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik për vlerësimin e gjendjes ekonomike financiare të konfirmuara nga organet përktëse, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

42. Nga auditimi i kryer edhe para vitit 2011, rezultoi se, është bërë rivlerësimi për çështje të veçanta si më poshtë:

-Në procedurat e prokurimit publik të kryera gjatë viteve 2010-2011, të shpallura dhe zhvilluara nga Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA, rezultoi një vendosje e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe 20, të Ligjit për Prokurimin Publik, mbi nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomik dhe trajtim të barabartë e jo diskriminues për të gjithë, si dhe në kundërshtim me nenet 46 e 53 dhe dokumentet standarde të tenderit.

- Kanë rezultuar shkelje më evidente në vendosjen nga ana e autoriteteve kontraktore të kriterëve klasifikuese të gabuara, për të vërtetuar “eksperiencat e ngjashme” të operatorëve ekonomikë; Ka parregullsi në vendosjen e kriterëve të gabuara për kualifikim sa i përket “kapaciteteve teknike”, si “Kërkesa për mjete e makineri, të cilat nuk përputhen me llojin dhe përmasat e objektit”; “Kërkesa për një numër më të madh punonjësish sesa nevojiten”; “Kërkesa për Liçensa profesionale, të cilat tejkalojnë përmasat e objektit” etj. të parashikuara në dokumentet e tenderit.

-Nga autoriteti kontraktor janë kërkuar licenca punimesh që i tejkalojnë përmasat e objektit të prokurimit si dhe kriteret në të cilët kërkohet një numër punonjësish më i madh seç janë nevojat reale për përballimin e kontratës, kërkesa të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kufizimin e numrit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, në kundërshtim me qëllimin dhe parimet bazë të ligjit për prokurimin publik siç janë nxitja e konkurrencës dhe trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë.

-U konstatuan raste kur kriteret e kualifikimit janë formuluar në mënyrë jo të qartë, evazive, dhe më pas ka rezultuar se mbi bazën e këtyre kriterëve autoritetet kanë s'kualifikuar një apo disa operatorë ekonomikë pjesëmarrës.

-Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar në mënyrë të plotë dhe të saktë vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, konform me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, ku përcaktohet se, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës.

-Vërehet se kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e procedurave të prokurimit.

-Në disa procedura prokurimi konstatohet se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kushtet e tenderit, sipas kërkesave të fituesit, duke krijuar një mjedis ku bizneset nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe një konkurrencë të padrejtë.

- Ka shkelje nga mënyra se si janë përpiluar specifikimet teknike, të cilat janë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik, në mënyrë AK të sigurojë qasje sa më

të madhe të mundshme për të gjithë operatorët dhe ofertuesit e interesuar ekonomik, që të mos favorizohen një ose më shumë operatorë ekonomikë të caktuar. *Trajtuar më hollësisht në faqen 155-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të forcojë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit, konkretisht në parashikimin e nevojës për prokurim, kërkesë për prokurim dhe miratimi i saj; hartimi dhe miratimi i urdhrat për zgjedhjen e procedurës së prokurimit, ngritjen e komisionit të vlerësimit, fondit limit dhe specifikimeve teknike; përgatitja, miratimi dhe hedhja në sistem e dokumenteve të tenderit; ngritja e komisionit dhe vlerësimi i ofertave; miratimi i raportit narrativ përmbledhës; njoftimi i ofertës fituese; përgatitja, miratimi, nënshkrimi i kontratës dhe pagesa e sigurimit të saj, mbikëqyrja e zbatimit të kontratës, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimi i transaksioneve dhe zbatimi i detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

43. Autoriteti kontraktor nuk ka bërë arkivimin e procedurës së prokurimit në sistem, në kundërshtim me udhëzimin e APP-së, trajtuar më hollësisht në Raportin e Auditimit. *Trajtuar më hollësisht në faqen 155-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, të marrë masat që me përfundimin e procedurave të prokurimit, të kryhen inventarizimi i brendshëm i dosjeve, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3, e 29, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Nga auditimi konstatohet se, ka pasur disa subjekte që kanë ushtruar aktivitetin e tyre në sipërfaqe të ri kontraktuar nga “Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA, Tiranë, përkatësisht në sipërfaqet e pa kontraktuar arrin vlerën mujore 97,445 lekë dhe në sipërfaqe më të mëdha se ato të kontraktuar nga Trajtimi i Studentëve Nr. 1, arrin vlerën 2,425,994 lekë. Kjo ka ardhur për mos ushtrimin e kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të “Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA, Tiranë, nga ish administratori [REDAKTUAR] veprime këto në kundërshtim me neni 4, i rregullores së brendshme si dhe neni 16 i statutit të shoqërisë nr. 8288/1, datë 12.09.2012. *Trajtuar më hollësisht në faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për arkëtimin e vlerës së dëmit në shumën 2,523,439 lekë, të shkaktuar nga ish administratori i “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, [] për mos ushtrim të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA.

Menjëherë

2. Ka patur mos arkëtime të qirave dhe kamatëvonesave nga subjektet të cilat kanë ushtruar veprimtari në Qytetin e Studentit për vitet 2012-2013, **duke shkaktuar një dëm ekonomik për shoqërinë në vlerën 1,735,324 lekë.** Kjo ka ardhur si rezultat i mos ushtrimit të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të Trajtimi i Studentëve Nr.1, nga ish administratori [] veprime këto në kundërshtim me nenin 4, të rregullores së brendshme si dhe neni 16 i statutit të shoqërisë nr. 8288/1, datë 12.09.2012. *Trajtuar më hollësisht në faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Për sa më sipër rekomandojmë

Të merren masa nga shoqëria, për të arkëtuar [] në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm, dëmin ekonomik në vlerën 1,735,324 lekë, për mos ushtrim të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, Tiranë.

Menjëherë

3. Për kontratën e lidhur me subjektin [] i me nr. prot.302, datë 27.04.2005”, ndërprerja e kontratës është bërë në mënyrë të njëanshme nga [] në cilësinë e ish-administratorit të Trajtimi i Studentëve Nr.1, SHA, në kundërshtim me kushtet e zgjidhjes së kontratës. Gjithashtu për vlerësimin e punimeve të kryera nga subjekti nuk është ngritur një komision për të konfirmuar investimet e kryera sipas nenit 5/pika 9, të kontratës **duke i shkaktuar shoqërisë një dëm ekonomik në vlerën 4,623,519 lekë** për mosmarrje pjesë të përfaqësuesve të shoqërisë në të gjitha shkallët e gjyqësorit. *Trajtuar më hollësisht në faqen 144-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë

Të merren masa nga “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, për të arkëtuar nga z. [] në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm dhe [] me detyrë juriste në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, dëmin ekonomik në vlerën 4,623,519 lekë, për mos ushtrim të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, për ndërprerje të kontratës në mënyrë të njëanshme dhe për mungesën e përfaqësimit në të gjitha shkallët e gjyqësorit .

Menjëherë

4. Për zbatimin e kontratës në objektin e prokurimit “*Hidroizolim tarrace të godinave nr. 4, 12, 13 dhe të Bibliotekës së Qytetit Studenti*”, të realizuar në vitin 2012, rezulton se akt dorëzimi i hartuar në datë 30.07.2012, për sheshin e ndërtimit dhe procesverbali për konfirmimin e

punimeve të kryera në objektin hidroizolim i tarracave, të përpiluar në prani të AK, përfaqësuar nga inxhinieri [REDAKTUAR] dhe OE fitues shoqëria [REDAKTUAR] shpk, me drejtues ligjor [REDAKTUAR] drejtues teknik dhe drejtues kantier z. [REDAKTUAR], janë në kundërshtim me kushtet të vendosura në kontratë ku thuhet se “Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më datë 26.07.2012” dhe pa asnjë argumentim mbi shtyrjen e afatit të fillimit të punimeve.

Nga Kontraktori “[REDAKTUAR] shpk, nuk janë realizuar punimet sipas grafikut të punimeve, duke sjellë si pasojë vonesa në realizimin e punimeve për 4 ditë, duke shkaktuar penalitete në vlerën prej 111,971 lekë. Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 111,971 lekë, të shkaktuar nga Kontraktori “..... shpk”, për vonesat të krijuara në zbatim të kontratës për objektin e prokurimit “Hidroizolim tarrace të godinave nr. 4, 12, 13 dhe të Bibliotekës së Qytetit Studenti.

Menjëherë

5. Në kontratën shtesë në vlerën 1,326,523 lekë, për lyerje të godinave nr.16, 17, 22, 23, të kryera me procedurën e prokurimit “Negocim pa botim paraprak”(20%), Shtesë Kontrate për “Lyerje me gëlqere të godinave Nr nga 1-12;14-17;dhe 20-29” të Qytetit të Studentit, nëntor 2012”, konstatohet se, AK nuk rezulton në kushtet e nevojës për punën shtesë të shkaktuar nga rrethana të paparashikuara në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 33, pika 5/a, dhe VKM-në Nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, kreu IV pika 5. Komisioni i marrjes në dorëzim për përfundimin e punimeve sipas kontratës fillestare, ka konstatuar se lyerja e godinave ka përfunduar në mënyrë të kënaqshme dhe konform kushteve të kontratës. Nga mbikëqyrësi i punimeve nuk janë evidentuar me proces-verbal punime të paparashikuara dhe të papërfshira në kontratën fillestare, pasi godinat nr, 16, 17, 22, 23, janë pjesë e kontratës fillestare. Për sa më lart procedura për shtesën e kontratës nuk është e bazuar në përputhje me ligjin nr. 9643 “për prokurim publik”, dhe përbën dëm ekonomik në vlerën 1,326,523 lekë . Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 1,326,523 lekë, të shkaktuar nga Kontraktori “[REDAKTUAR]”, shpk, përfituar padrejtësisht për punime të panevojshme për tu kryer në lyerjen e godinave të studentëve me nr.16, 17, 22 dhe 23.

Menjëherë

6. Në zbatim të kontratës së lidhur më datë 22.05.2013, midis AK dhe [REDAKTUAR] shpk, me Objekt prokurimi “Lyerje me gëlqere të godinave 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 29 të Qytetit Studenti” të Trajtimi i Studentëve Nr.1, SHA, Tiranë, rezulton se nga mbikëqyrësi i punimeve “[REDAKTUAR] shpk, ka njoftuar Autoriteti Kontraktor, se sipërmarrësi i punimeve [REDAKTUAR] shpk, nuk ka filluar punimet sipas afatit të vendosur në kontratë, por kanë filluar në datën 04.07.2013, me vonesë për 43 ditë të pajustificuara nga asnjë lloj arsye. Punimet kanë përfunduar në 22.08.2013, jashtë afatit të përcaktuar në kontratën e lidhur ku thuhet “Afati i përfundimit të punimeve është brenda 50 ditëve nga data e lidhjes së kontratës” pra punimet duhet të përfundonin në datën 01.07.2013. Për sa më sipër kontraktori [REDAKTUAR] shpk,

ka krijuar vonesa në realizimin e kryerjes së punimeve për 52 ditë duke shkaktuar penaltete në vlerën prej 1,040,219 lekë. Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 1,040,219 lekë, të shkaktuar nga kontraktori [REDAKTUAR] shpk, për vonesa në zbatimin e kontratës për “Lyerje me gëlqere të godinave 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 29 të Qytetit Studenti”.

Menjëherë

7. Për zbatimin e kontratës me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike të Qytetit Studenti” për vitin 2013, të lidhur midis AK dhe OE “[REDAKTUAR]” shpk, me vlerë 2,894,110 lekë, u konstatua se nga AK, nuk ishte ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me udhëzimin e MF Nr. 30, datë 27.12.2011, kreu II pika 42, për të cilën mban përgjegjësi titullari i njësisë. Artikujt janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjes nr. 39, datë 06.06.2013, sipas faturës tatimore nr. 12 datë 06.06.2013, në vlerë totale 3,231,996 lekë (me diferencë nga kontrata në sasi për 8 (tetë) artikuj me vlerë totale 240,936 lek). Kjo diferencë është bërë hyrje në magazinë sipas fletë hyrjes nr. 3, datë 15.01.2014. Për sa më sipër nga kontraktori “[REDAKTUAR]” shpk, janë krijuar vonesa në realizimin e kontratës “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike të Qytetit Studenti” për 190 ditë, duke shkaktuar penaltete në vlerën prej 868,233 lekë, dhe të bëhet arkëtimi i vlerës së sigurimit të kontratës prej 360,000 lekë. Trajtuar më hollësisht në faqen 87-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 868,233 lekë, të shkaktuar nga kontraktori “[REDAKTUAR]”, shpk, dhe vlerën e sigurimit të kontratës prej 360,000 lekë.

Menjëherë

8. Në procedurat e prokurimit publik të kryera gjatë viteve 2010-2011, të shpallura dhe zhvilluara nga Trajtimi i Studentëve Nr. 1, SHA, rezultoi se KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. KVO ka s'kualifikuar për mangësi të rezultuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta të operatorit ekonomik, dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik, kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetin ligjor të ofertuesit të shpallur fitues, është në kundërshtim me pike 2 të nenin 44, me germën ç, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe me piken 2, të Kreut VII, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1, që ka të bëjë me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, me pasojë që shuma 10,093,473 lekë, të mos

përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të Trajtimit të Studenteve Nr. 1, SHA, Tiranë, duke shkaktuar dëm ekonomik për shoqërinë, përkatësisht:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese **në vlerën 2,010,737 lekë**;

-Në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë **në vlerën 582,670 lekë**, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese;

-Në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mobilje”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese **në vlerën 3,845,400 lekë**;

Në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim muri mbajtës, rrethues mbrapa godinave 22 dhe 23 të Qytetit Studenti ”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë **në vlerën 708,792 lekë**, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese;

Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese **në vlerën 2,698,964 lekë**;

Në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, nga KVO është marrë në konsideratë dhe është shpallur fitues shoqëria “”, **me vlerë 246,910 lekë**, më të lartë nga shoqëria Trajtuar më hollësisht në faqen 155-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Të merren masa nga Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, SHA, për të arkëtuar nga z në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm, dhe nga z ish-zv/administratori në cilësinë e kryetarit të KVO-së, të dëmit ekonomik në vlerën 10,093,473 lekë, për arsye se; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën +2,010,737 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 582,670 lekë, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mobilje”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën 3,845,400 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim muri mbajtës, rrethues mbrapa godinave 22 dhe 23 të Qytetit Studenti ”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 708,792 lekë, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën 2,698,964 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, nga KVO është marrë në konsideratë dhe është shpallur fitues shoqëria me vlerë 246,910 lekë, më të lartë nga shoqëria

9. Konstatohet se në disa raste për veprimet e kryera me arkë dhe me bankë, ka pasur parregullsi përkatësisht: Në një rast me vlerë 252,600 lekë, mungojnë dokumentet justifikues për kryerje shërbimi; Në dy raste me vlerë 586,320 lekë, janë paguar një subjekti privat pa u përdorur asnjë procedure prokurimi, por vetëm me kontratë të lidhur nga ish Administratori i Përgjithshëm. *Trajtuar më hollësisht në faqen 79-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Për sa më sipër rekomandojmë

Shoqëria të marrë masa për të arkëtuar vlerën prej 252,600 lekë, nga shkaktarët e dëmit, ish Administratori i përgjithshëm z. [REDAKTUAR] ish përgjegjës i sektorit elektrik z. [REDAKTUAR], dhe ish anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla zj. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Të arkëtohet në arkën e shoqërisë vlera prej 586,320 lekë, nga shkaktari i dëmit, ish Administratori i përgjithshëm z. [REDAKTUAR]

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin nr. 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive të punës, i kërkojmë drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

1. “Vërejtje me paralajmërim”

a. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë drejtore e drejtorisë së planifikimit, për arsye:

Nuk ka dërguar brenda afateve në MZHETS dhe në MAS, për miratimin e projektbuxhetit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012, 2013 dhe 6-mujori i parë i vitit 2014; Nuk ka përfunduar ende procesi për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë pranë Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë, të nisura që nga vitit 2012; Nuk janë bërë pagesat e taksave vendore që priten të bëhen nga rivlerësimi i tyre për regjistrimin e pasurisë nga Bashkia; nuk ka aplikuar fatura tatimore për të ardhurat që realizohen nga dhënia me qira e ambienteve nga akomodimi i studentëve; nuk ka provizionuar detyrime në shumën 3,343,014 lekë, për arkëtimin e detyrimeve të trashëguara në vite; ka kontabilizuar gabim në llogaritë aktive afatgjata jo materiale investimin e një projekti të kryer në vitet 2005 dhe 2006, duke i klasifikuar si aktive afatgjata jo materiale (klasa 2), si dhe ka aplikuar amortizimin në masën 15%, mbi vlerën fillestare të projektit në shumën 1.6 milion lekë; nuk ka likuiduar detyrimet ndaj furnitorëve në shumën 221,091,752 lekë, të trashëguara në vite ndaj CEZ, ndaj UKT-së; dhe detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për investime etj; nuk ka provizionuar shumën 192,222 lekë gjendje në llogarinë Të pagueshme ndaj punonjësve, që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës para vitit 2012 dhe nuk u dihet adresa; nuk ka provizionuar detyrimet në shumën 2,362,579 lekë, përkatësisht: për detyrime të trashëguara nga vitit 2004, ndaj ISKSH në shumën 985,762 lekë; detyrime të trashëguara nga vitit 2004 në shumën 1,100,403 lekë, të papaguara ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore që nga vitit 2004; detyrimet në shumën 24,000 lekë, që përfaqëson detyrimet përmbartimore të trashëguara nga vitet të mëparshme ndaj një punonjëse; detyrimet në shumën 252,414 lekë, që përfaqëson pagesat e lejeve të zakonshme për punonjësit që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës për sasinë e ditëve për lejen e zakonshme, pas datës që

kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës; Nuk ka masa për të derdhur detyrimet ndaj shtetit në shumën 1,991,995 lekë, për vitin 2012, dhe në shumën 1,739,529 lekë, për vitin 2013; nuk u janë kthyer studentëve detyrimet për garancitë të arkëtuara, në shumën 8,823,800 lekë, në vitin 2012; Janë konstatuar parregullsi në procedurat e ndjekura për inventarin e kryer gjatë vitit 2012,

2. zj. [REDAKTUAR] me detyrë juriste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Për arsye se, në çështjen civile me kohëzgjatje 1 vit, pala e paditur “Trajtimi i Studenteve Nr. 1, SHA, sot “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 SHA”, nuk ka qenë prezent në seancat gjyqësore dhe si pasojë nuk ka pasur asnjë provë të dorëzuar nga ana e palës së paditur për një zgjidhje të çështjes. Pala e Paditur ka marrë njoftim për seancat gjyqësore dhe nuk disponon asnjë dokument për të justifikuar mos prezencën. Në mungesë të saj seancat janë zhvilluar në prani të avokatit të shtetit por nuk justifikon kjo përfaqësimin e kësaj pale.

Nga ana juristet së shoqërisë nuk është bërë ankimin në Gjykatën e lartë për këtë çështje por avokatura e shtetit ka bërë rekurs në Gjykatën e lartë e cila pas shqyrtimit të gjykimit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi për mos marrje pjesë në seancat gjyqësore znj. [REDAKTUAR] në cilësinë e Juristes në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, bazuar në urdhrin nr. 208, prot. 364, datë 17.09.2008 ku thuhet se: *“përfaqëson shoqërinë në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit”*.

3. zj. [REDAKTUAR] me detyrë drejtore e drejtorisë së shërbimeve mbështetëse, në cilësinë e anëtares së NjHD, për arsye se:

Njësia e Hartimit të Dokumentave ka vendosur kritere për kualifikim për çdo procedurë prokurimi të njëjta, duke bërë që për procedurat e prokurimeve, të ketë ankesa nga Oferuesit Ekonomik dhe tenderat të jenë të destinuar për anulim.

-Nga Njësia e Hartimit të Dokumentave nuk janë vendosur kritereve të veçanta për kualifikim të operatorëve ekonomik, në përputhje me natyrën për të cilën do të kryhej prokurimi.

Trajtuar në procesverbalet me nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, datë 10.10.2014.

II. “Vërejtje me shkrim”

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë drejtore e drejtorisë së burimeve njerëzore, për arsye se: janë konstatuar parregullsi gjatë procesit të inventarizimit të kryer për vitet 2012 dhe 2013, si dhe nuk ka ndjekur procesin e inventarizimit të vlerave materiale të shoqërisë nga fillimi deri në përfundim të tij.

- Komisioni i inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbal për konstatimet e bëra, në përfundim të procesit të verifikimit të bazës materiale në bujtina, por komisionet kanë firmosur mbi kartelat e aktiveve të gjeneruara nga financa.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, është bërë kallzim penal për 2(dy) persona

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Luljeta Shtylla, Lavdie Fshazi, Elira Cukalla, Valentina Sula dhe Skender Muça, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit

Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretar i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLI I LARTË ISHTETIT